

## **ECO MARKET FOOD SHPK**

*Pasqyrat Financiare Vjetore*

*per periudhen nga*

*1 Janar 2021 deri 31 Dhjetor 2021*



## PERMBAJTJA

- I. Pasqyrat e pozicionit financiar**
- II. Pasqyrat e performances**
- III. Pasqyrat e fluksit te mjeteve monetare**
- IV. Pasqyra e levizjeve ne kapitalin neto**
- V. Raporti i Auditit te pavarur**
- VI. Shenimet shpjeguese**

- 1. Informacion i përgjithshem per shoqerine
- 2. Deklarata e përputhshmërise
- 3. Përmbledhëse e politikave te rëndësishme kontabël
  - a) *Të përgjithshme*
  - b) *Të ardhurat*
  - c) *Vlerësimi i likuiditeteve*
  - d) *Monedhat e huaja*
  - e) *Aktivitet afatgjata materiale*
  - f) *Tatimi mbi fitimin*
  - g) *Llogaritë e arkëtueshme*
  - h) *Mjetet monetare*
  - i) *Furnitorë dhe detyrime të tjera*
  - j) *Krahasueshmëria*
- 4. Mjetet monetare
- 5. Inventar
- 6. Klientë për mallra, produkte e shërbime
- 7. Llogari të tjera të arkëtueshme
- 8. Shpenzime te shtyra
- 9. Llogari të pagueshme
- 10. Detyrime tatimore
- 11. Të ardhurat nga shitja
- 12. Shpenzime personeli
- 13. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit
- 14. Tatimi mbi fitimin
- 15. Angazhime e detyrime të mundshme
- 16. Ngjarjet pas datës së bilancit



## 1. Informacion i përgjithshem për shoqërinë

"Eco Market Food" shpk, është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara më datë 05/01/2009 në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Mbi shoqëritë tregtare" dhe është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me numrin e identifikimit K91312511U.

Selia ligjore e shoqërisë është në adresën: Tirane Vore VORE Pasuria me Nr 132/14/7, Zone Kadastrale 2183, Vol 6, Fq.112.

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 159.000.000,00 Lek. Ortakët e shoqërisë janë "Agron Duka", zotërues i 50% të kapitalit të Shoqërisë dhe "Armand Duka", zotërues i 50% të kapitalit të Shoqërisë .

Ne date 25.09.2021 z.Agron Duka kalon e ne cilesine e zoteruesit pasiv te 50% te kapitalit qe zoteron dhe z.Armand Duka fiton cilesine e "Personit te besuar"

Shoqëria ka për objekt aktivitetin: Veprimtari në fushën e prodhimit, magazinimit e tregtimit të prodhimeve e ushqimeve blegtorale e bujqësore. Tregti, Import-Eksport duke përfshirë magazinimin dhe tregtimin me shumicë dhe me pakicë të mallrave ushqimore, industriale, elektroshtëpiake, duhanit dhe cigareve, pijeve të ndryshme alkoolike ose jo, automjeteve, makinerive e pjesëve të këmbimit për to dhe të lëndëve drusore, etj. Veprimtari në fushën e industrisë blegtorale e ushqimore, ndërtimit dhe tregtimit etj.

## 2. Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të përmisuara (SKK) dhe ligjin nr. 9228 datë 29 Prill 2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Në bazë të urdhërit nr.64 datë 22.07.2014, "Për shpalljen e standarteve kombëtare të kontabilitetit të përmisuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të përmisuara duke filluar nga 1 Janar 2015. Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 Gusht 2014.

## 3. Përmbledhëse e politikave te rëndësishme kontabël

### a) Të përgjithshme

Këto pasqyra financiare janë përgatitur bazuar në parimin e koston historike dhe në përputhje me Standartet Shqiptare të Kontabilitetit. Këto pasqyra financiare janë paraqitur në LEK Shqiptar ("LEK") që është monedha raportuese e shoqërisë.

### b) Të ardhurat

Në rastet kur rezultati i një transaksioni që përfshin ofrimin e shërbimeve mund të matet me besueshmeri, të ardhurat me këtë transaksion njihen në varësi të fazës së përfundimit të shërbimit në fund të periudhës së raportimit. Rezultati i një transaksioni mund të matet me besueshmëri kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- i. Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmeri;
- ii. Arkëtimi i pagesës nga kryerja e shërbimit është i mundur;
- iii. Volumi i kryerjes së shërbimit në datën e bilancit mund të matet me besueshmëri;
- iv. Shpenzimet e bëra për shërbimin në datën e bilancit, si dhe ato që do të bëhen për përfundimin e tij mund të maten me besueshmëri.

### c) Vlerësimi i likuiditeteve

Gjendjet e likuiditeteve përfshijnë gjendjen e parave në arkë dhe në llogaritë rrjedhëse në bankë në lekë dhe në monedha të huaja.



#### d) Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në LEK me kursin e këmbimit në datën që bëhen transaksionet. Të ardhurat dhe humbjet nga kurset e këmbimit, që vijnë për shkak të shlyerjeve të këtyre transaksioneve dhe të rivlersimit të aktiveve dhe detyrimeve monetare të shprehura në monedhë të huaj në fund të periudhës, njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të këmbimit sipas bankës së Shqipërisë të përdorura për përgatitjen e pasqyrave financiare (lek kundrejt monedhës perkatëse) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 janë si më poshtë:

Monedha	2021	2020
EUR	120.76	123.70
USD	106.54k	100.84

#### (e) Aktivet afatgjata materiale

##### i. Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata materiale, maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlersimi. Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me blerjen e aktivitet. Kostot e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshijnë koston e materialeve dhe punës direkte që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me sjelljen e aktivitet në gjëndje pune për qëllimin e caktuar, kostot e cmontimit dhe lëvizjen e aktiveve të ndryshme dhe kthimin e vendodhjes së tyre në gjëndjen e mëparshme.

Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato stabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

##### ii. Kostot në vijim

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundur që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

##### iii. Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas legjislacionit shqiptar duke përdorur metodën lineare të amortizimit. Toka dhe aktivitet në proces nuk amortizohen. Normat e amortizimit të zbatuara sipas kategorive të aktiveve kryesore janë si më poshtë:

	%
Ndërtesa	5
Instalime teknike dhe mobilje	20
Mjete transporti	20
Pajisje informatike	25



#### (f) Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin aktual është bazuar në shumën e tatimit të pritshëm për tu paguar llogaritur sipas legjislativës Shqiptare si dhe përcaktimeve në rregullat bazë kontabël në Shqipëri duke përdorur normën e tatimit të zbatueshëm në datën e hartimit të Pasqyrave si dhe çdo rregullim për tatim fitimin e pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Përqindja e tatimit në fuqi gjatë vitit 2021 ishte në masën 15%.

#### (g) Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme paraqiten me vlerën neto të realizueshme, që është kosto minus provigjionin për llogaritë e dyshimta.

#### (h) Mjetet monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë paratë në dorë, depozitat në banka, investimet afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe afat maturimi deri në tre muaj, që janë lehtësisht të konvertueshme në një shumë të njohur mjeteve monetare dhe nuk janë subjekt i riskut të ndryshimit të vlerës së drejtë.

#### (i) Furnitorë dhe detyrime të tjera

Furnitorët dhe detyrimet e tjera paraqiten me kosto.

#### (j) Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikën kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kontabël Shqiptar.

### 4. Mjetet monetare

Mjetet monetare më 31 Dhjetor 2021 dhe 2020 janë të përbëra si më poshtë:

<b>Bankat</b>	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Banka Eur	(23,909,967)	39,113,902
Banka Leke	25,413,532	13,073,590
Banka USD	44,679	48,360
<b>Grand Total</b>	<b>1,548,244</b>	<b>52,235,852</b>

<b>Arkat</b>	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Arka Leke	8,179,237	5,932,127
Arka Euro	282,167	243,678
Arka ne USD	-	-
<b>Grand Total</b>	<b>8,461,404</b>	<b>6,175,805</b>



## 5. Inventar

Gjendja e inventarit më 31 Dhjetor 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

<b>Inventaret</b>	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Mallra per ri	285,906,471	290,054,927
<b>Grand Total</b>	<b>285,906,471</b>	<b>290,054,927</b>

## 6. Klientë për mallra, produkte e shërbime

Llogaritë e arkëtueshme përfaqësojnë detyrime të paarkëtuara nga klientët në datën e mbylljes së Pasqyrave Financiare. Llogaritë e arkëtueshme më 31 Dhjetor 2021 dhe 2020 janë të përbëra si më poshtë:

	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Kliente per arketim	290,694,607	205,428,069
<b>Grand Total</b>	<b>290,694,607</b>	<b>205,428,069</b>

## 7. Llogari të tjera të arkëtueshme

Gjendja e llogarive të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 paraqitet si më poshtë:

<b>Te tjera te arketueshme</b>	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Debitore te Tjere	94,235,801	56,169,758
Tatim mbi Fitimin	4,653,905	11,495,193
Llogari ne Dogane	8,259,674	6,789,674
<b>Grand Total</b>	<b>107,149,380</b>	<b>74,454,625</b>

## 8. Shpenzime te shtyra

Gjendja e Shpenzimeve te shtyra më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

<b>Shpenzime te shtyra</b>	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Llogari per shperndarje shpenzimesh	(1,486,497)	849,690
Shperndarje shpenzimi Kasa Fiskale	1,660,495	1,608,803
Shperndarja shpenzimeve te uniformave	87,373	274,787
Shperndarja shpenzimeve te ONE	508,322	1,167,712
Shperndarja shpenzimi Marketing	-	84,333
<b>Grand Total</b>	<b>769,693</b>	<b>3,985,325</b>



## 9. Llogari të pagueshme

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj furnitorëve dhe punonjesve. Llogaritë e pagueshme më 31 Dhjetor 2021 dhe 2020 paraqiten si më poshtë:

Llogari te Pagueshme	2021	2020
Furnitore	(929,455,202)	(878,716,166)
Pagat e Punojsve	(668,590)	(189,255)
<b>Grand Total</b>	<b>(930,123,791)</b>	<b>(878,905,420)</b>

## 10. Detyrime tatimore

Llogaritë e pagueshme më 31 Dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

Viti 2021	Detyrimi	Likuiduar	Mbetur pa likuiduar
Tatim Mbi Vleren e Shtuar	83,253,041	83,617,844	(364,803)
Tatim Fitimi	6,841,288	-	-
<i>Kontributet e Sigurimeve Shoqërore</i>	<i>29,540,083</i>	<i>29,540,083</i>	-
<i>Kontributet e Sigurimeve Shëndetësore</i>	<i>4,106,890</i>	<i>4,106,890</i>	-
<i>Totali i Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi</i>	<i>3,015,980</i>	<i>3,015,980</i>	-
Tatim ne Burim	9,359,487	9,356,755	2,732
<b>TOTAL</b>	<b>136,116,769</b>	<b>129,637,552</b>	<b>(362,071)</b>



## Pasqyra e Performances (Pasqyra e te Adhurave dhe Shpenzimeve)

### 11. Të ardhurat nga shitja

Shitjet neto 31 Dhjetor 2021 dhe 2020 janë të përbëra si më poshtë:

Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	2021	2020
Te ardhura nga aktiviteti kryesor	3,151,224,142	2,465,324,407
<b>Totali</b>	<b>3,151,224,142</b>	<b>2,465,324,407</b>
Te ardhura tjera	2021	2020
Shitja e AAGJ materiale Zbritje nga furnitoret		
Te ardhura te tjera	268,396	1,801,333
<b>Totali</b>	<b>268,396</b>	<b>1,801,333</b>

### 12. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021 dhe 2020 paraqiten si më poshtë:

Shpenzime Personeli	2021	2020
Pagat	120,584,689	116,294,961
Sigurimet Shoq.Shend.	20,139,287	19,372,368
<b>Grand Total</b>	<b>140,723,976</b>	<b>135,667,329</b>





### 13. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzime të tjera për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

Shpenzime te tjera shfrytezimi	2021	2020
Energji,Uje,Karburant	57,384,138	46,344,549
Te tjera	82,406,407	95,282,195
Qira	75,563,405	70,648,817
Mirembajtje	16,918,682	13,860,606
Publicitet dhe Reklama, Marketing	13,874,555	24,492,484
Dieta	10,222,778	10,213,485
Sherbime Bankare	3,124,911	3,084,541
<b>Grand Total</b>	<b>259,494,877</b>	<b>263,926,676</b>

### 14. Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri.

Tatimi mbi fitimin është i pagueshëm në normën 15% bazuar mbi fitimin neto për periudhën dhe nuk korrigjohen për efekte tatimore në përputhje me legjislacionin shqiptar tatimor. Deklarimi dhe pagesa e detyrimit të tatimit mbi fitimin bëhet cdo vit pranë autoriteteve tatimore, por fitimi dhe humbja fiskale mbeten të përllogaritura derisa të kontrollohen nga këto autoritete tatimore.

Fitimi (humbja) neto e vitit financiar i paraqitur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve detajohet si me poshtë:

Tatimi mbi Fitimin	2021	2020
Humbja para tatimit		(21,808,183)
Fitim i periudhes	65,176,669	
Shpenzime te panjohura si me poshte:	(55,255,710)	(53,518,516)
Humbje Fiskal	-	-
Humbje fiskale e mbartur	(74,823,795)	(31,710,333)
Shpenzimet per Tatim Fitimin	(6,841,288)	



### 15. Angazhime e detyrime të mundshme

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekt negativ në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 Dhjetor 2021 shoqëria nuk ka angazhime kapitale e detyrime të mundshme që kërkojnë paraqitje në pasqyrat financiare.

### 16. Ngjarjet pas datës së bilancit

Asnjë ngjarje e rëndësishme e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare nuk ka ndodhur pas datës së miratimit të pasqyrave financiare.

Tirane, me \_\_\_/07/2021

HARTOI

ADMINISTRATORI

Rovena Beja

Elda Kercova

Rovena Beja  


